



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS

RREGULLORE E
REPREZENTACIONIT

Prishtinë, Dhjetor 2022

Bazuar në Nenin 35 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, Bordi i FAK-ut në mbledhjen e mbajtur më 01.12.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE TË REPREZENTACIONIT

për mënyrën dhe kushtet e kryerjes së veprimeve përfaqësuese të Federatës Atletike të Kosovës

1. Dispozitat themelore

Neni 1.

Rregullorja për veprimet përfaqësuese të FAK-ut përcakton mënyrën se si duhet të funksionojë ekipi kombëtar gjatë stërvitjeve, përgatitjeve, garave dhe aktiviteteve të tjera të përcaktuara nga Bordi i FAK-ut.

Neni 2.

Rregullorja përcakton mënyrën se si vendosen pjesëmarrësit për garat dhe përgatitjet si dhe për aktivitete të tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme dhe vlen për atletët, trajnerët, stafin mjekësor, stafin teknik, si dhe për udhëheqësin e rrugës.

Neni 3.

Rregullorja përcakton të drejtat dhe detyrimet si dhe rregullat e sjelljes së të gjithë personave që marrin pjesë në aktivitetet e përmendura (në tekstin e mëtejshëm si anëtarë të ekipit kombëtar).

Neni 4.

Të gjitha dispozitat e kësaj Rregulloreje duhet të harmonizohen me dispozitat e Ligjit për Sportin dhe aktet normative të FAK-ut, EA dhe WA.

2. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit kombëtar

Neni 5.

Të drejtat dhe detyrimet e atletit të kombëtares janë të performoj për kombëtaren sa herë që përzgjidhet për të. Mungesa e pajustificuar ose refuzimi i ftesës për grumbullimin e ekipit kombëtar është shkak për fillimin e procedimit disiplinor.

Çdo anulim i pjesëmarrjes duhet të jetë në kohë dhe i dokumentuar.

Neni 6.

Përfaqësuesit e kombëtares janë të detyruar të kujdesen për shëndetin e tyre dhe të kolegëve të tyre. Sigurimi personal rekomandohet për çdo anëtar të ekipit kombëtar.

FAK-ut nuk merr përsipër detyrimin e sigurimit gjatë përgatitjeve ose rimbursimin e kostove që rrjedhin nga ngjarje të mundshme negative.

FAK-ut merr përsipër detyrimin e sigurimit gjatë qëndrimit në një nga garat ndërkombëtare nga programi FAK-ut.

Neni 7.

Kostoja e transportit të kombëtares nga vendbanimi në vendin e grumbullimit të kombëtares dhe kthimi në vendbanimin e kombëtares përballohet nga klubet vendase të kombëtares.

Në raste të caktuara, Sekretari i përgjithshëm në bashkërendim me kryetarin e FAK-ut, në përputhje me planin financiar të FAK-ut, mund të marrë vendim për mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe kjo shumë monetare përcaktohet nga çmimi i biletës së rregullt të autobusit, trenit ose aeroplanit.

Neni 8.

Nëse zyra e FAK-ut ka organizuar udhëtimin dhe akomodimin për garë, çdo udhëtim në të njëjtin vend në një organizatë apo klubi nuk lejohet.

Në situata të veçanta dhe me miratimin e përzgjedhësit të kombëtares, atleti mund të udhëton në garë me organizatën e tij, për kombëtarja ose klubi i tij mbajnë përgjegjësi të plotë për ndodhjen eventuale të një ngjarje të dëmshme, si dhe të gjithë koston e udhëtimit pa mundësi rimbursimi.

Neni 9.

Të gjithë anëtarëve të ekipit kombëtar pajisen me akomodim dhe ushqim në përputhje me rregullat dhe mundësitë e organizatorëve. Një anëtar i ekipit kombëtar nuk mund të ndryshojë objektin e akomodimit pa miratimin e organizatorit ose udhëzuesit me pëlqimin paraprak të përzgjedhësit të ekipit kombëtar.

Neni 10.

Përfaqësuesit duhet të respektojnë orarin e aktiviteteve ditore - kohën e pushimit, kohën e stërvitjes, kohën e ushqimit, kohën e takimit të ekipit dhe të mos shqetësojnë kolegët e tyre në aktivitetet e tyre të caktuara.

Neni 11.

Përfaqësues nuk mund të jenë personat ndaj të cilëve është nisur procedimi disiplinor në klub, FAK-ut apo procedime lidhur me përdorimin e substancave të paligjshme në sport.

Neni 12.

Përfaqësuesit janë të detyruar të mbajnë komunikim me mediat. Deklaratat duhet të jenë objektive dhe pohuese.

Kur anëtarët e ekipit kombëtar marrin pjesë në aktivitete të organizuara dhe të kryera nga FAK-ut, paraqitjet në media dhe fotosesionet duhet të jenë ekskluzivisht në pajisjet zyrtare të ekipit kombëtar me sponsorë të veçuar të FAK-ut.

Një detyrim i tillë përfundon kur rregullat e medias IOC, WA, EA janë në fuqi.

Çdo paraqitje mediatike që i shkakton dëm Federatës Atletike të Kosovës, në çfarëdo forme, mund të jetë bazë për fillimin e procedurës disiplinore dhe kompensimin e dëmit material.

3. Pajisjet përfaqësuese

Neni 13.

Pajisjet përfaqësuese janë unike dhe janë pronë e përhershme e FAK-ut. Pajisja u jepet për përdorim të përkohshëm përfaqësueseve të kombëtares me firmën në anën e pasme.

Anëtarët e Kombëtares janë të detyruar t'i trajtojnë pajisjet si nikoqirë të mirë dhe t'i përdorin ato vetëm gjatë paraqitjeve të ekipit kombëtar.

Pajisjet e ofruara për shfaqjet e garave nuk mund të përdoren për stërvitje të përditshme.

Neni 14.

Përfaqësuesit e përhershëm dhe trajnerët janë të detyruar të sjellin në garë pajisjet që kanë marrë.

Neni 15.

Kombëtares e rastit janë të detyruar t'ia kthejnë pas përfundimit të garës pajisjet që kanë marrë hua për garim (veshmbathje ceremoniale). Shkatërrimi ose humbja e pajisjeve është përgjegjësi e individit dhe klubit nga vjen.

4. Atletët

Neni 16.

Për të udhëtuar jashtë vendit, sportistët duhet të kenë dokumente të vlefshme udhëtimi, të respektojnë të gjitha ligjet e Republikës së Kosovës, si dhe detyrimet e përcaktuara nga ligjet e vendit ku ata udhëtojnë dhe në të cilin qëndrojnë.

Çdo ngjarje të mundshme të dëmshme të shkaktuar nga sjellje të pahijshme janë përgjegjës atleti i Kombëtares që i ka shkaktuar, klubi i tij, si dhe prindërit, nëse është i mitur.

Neni 17.

Lista e atletëve për gara, përgatitje dhe aktivitete të tjera përcaktohet nga rregulloret – normat adekuate të ekipit kombëtar në bazë të vlerësimit profesional, kritereve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me konsultim paraprak me Këshillin Profesional.

Neni 18.

Vetëm atletët plotësisht të shëndetshëm dhe të përgatitur udhëtojnë në garat dhe përgatitje, të cilat garantohen nga klubet ku ata janë anëtarë, si dhe nga trajnerët e tyre. Në rast se një atlet udhëton në garë i dëmtuar (sëmurë), shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit do të përballohen nga atleti dhe/ose klubi në të cilin ai është anëtar.

Neni 19.

Atletët janë të detyruar të sillen në përputhje me Kodin e Etikës së FAK-ut.

Atletët duhet të respektojnë kolegët e tyre atlet, konkurrentët e tyre në vetë garën, si dhe trajnerët, udhëheqësin e rrugës dhe pjesëmarrësit e tjerë në aktivitetet përfaqësuese. Në kohën e lirë, të cilën duhet ta kalojnë në frymën e orarit të caktuar ditor, janë të obliguar ta përfaqësojnë Republikën e Kosovës me dinjitet dhe krenari.

4.1 Gara individuale

Neni 20.

Një atlet fiton të drejtën për të shkuar në garë me rezultatin e tij, i cili duhet të jetë në nivelin e standardit (normës) të paracaktuar nga FAK-ut për atë garë, ose normës së federatës ndërkombëtare. Kriteret e pjesëmarrjes në garat ndërkombëtare për çdo vit miratohen nga Bordi i FAK-ut me propozimin e Këshillit Profesional dhe Përzgjedhësit.

Neni 21.

Në rast të mosekzistimit të standardeve për një garë të caktuar, përzgjedhësi i ekipit kombëtar, pas konsultimit paraprak me Këshillin Profesional, dhe mbi bazën e respektimit të barazisë së të gjitha disiplinave, sjell standardet që do të vlejné për atletët tanë.

Neni 22.

Afati për arritjen e standardeve për të shkuar në garë përcaktohet në kohën e duhur dhe zakonisht është në përputhje me afatin e federatës ndërkombëtare, por më i hershëm në kohë.

4.2 Garat ekipore

Neni 23.

Procesi i përcaktimit të anëtarëve të ekipit kombëtar për garat ekipore përcaktohet në kohën e duhur dhe konsiston në:

1. Tabelat e rezultateve sezonale
2. Garat zgjedhore
3. Gjendja e formës dhe shëndetit të atletëve
4. Mundësia e sportistëve për të performuar mirë në disa disiplina

Në rastet kur ka dy ose më shumë atlet me rezultate të ngjashme, e drejta për të performuar në kombëtare do të përcaktohet në bazë të rezultatit të arritur në garën përzgjedhëse.

4.3 Përgatitjet

Neni 24.

Atletët kanë të drejtë të marrin pjesë në përgatitje në bazë të kriterëve të përcaktuara nga rregullorja e performancës në konsultim me Këshillin Profesional. Përgatitjet organizohen nga zyra e FAK-ut. Akomodimi është në nivelin e një hoteli me dy-tre yje, dhe kostoja e transportit deri në hotel është në përgjegjësi të Federatës. Çdo kërkesë që i referohet një standardi më të lartë se sa më sipër nuk është e detyrueshme për FAK-ut dhe në rast të ndonjë ngjarjeje negative, FAK-ut nuk merr përgjegjësi.

Neni 25.

Një atlet që udhëton në përgatitjet i dëmtuar do të kthehet prej tyre menjëherë. E gjithë kostoja do të përballohet nga klubi, atlet ose prindi nëse është i mitur.

Neni 26.

Një atlet që lëndohet gjatë stërvitjes do të kthehet në shtëpi me shpenzimet e FAK-ut. Këtë vendim e merr udhëheqësi i rrugës në konsultim me kryetrajnerin e stërvitjeve.

Neni 27

Atletët që kryejnë përgatitjet e tyre sipas programeve individuale, mbyllin kontratën me FAK-ut për zbatimin e programit, në të cilën përpunohen të gjitha detajet e përdorimit të fondeve të destinuar për zbatimin e programeve të tyre.

5. Trajnerët dhe veprimet përfaqësuese

Neni 28

Lista e trajnerëve për garat, përgatitjet dhe aktivitetet e tjera përcaktohet nga rregullorja e performancës në konsultim me Këshillin Profesional.

Neni 29.

Trajnerët mund të përfshihen në ekipin kombëtar vetëm në bazë të akteve normative të FAK-ut, që do të thotë se një trajner pa licencë si dhe dispozita të tjera të përcaktuara me aktet normative të FAK-ut nuk mund të marrë pjesë në garat ndërkombëtare dhe vendase si dhe në përgatitjet në përbërjen e ekipit kombëtar.

Neni 30.

Trajnerët, atletët e të cilëve janë nën suspendim për shkak të përdorimit të vërtetuar të dopingut, nuk mund të marrin pjesë në veprime përfaqësuese për kohëzgjatjen e dënimit ose pezullimit të përkohshëm.

Përrjashtimisht, në disa raste, Bordi i FAK-ut mund të lejojë trajnerët të punojnë pas konsultimit me Komisionin e Shëndetësisë dhe sekretarin e përgjithshëm të FAK-ut.

5.1 Gara individuale

Neni 31.

Trajnerët, atletët e të cilëve kanë një shans më të mirë për një vendosje më të mirë në garë, udhëtojnë me përparësi në garat individuale. Mundësia e suksesit të një sportisti individual përcaktohet nëpërmjet rezultateve të kampionateve të mëparshme si dhe kritereve dhe vendimeve të tjera të përzgjedhësit të kombëtares në konsultim me Këshillin Profesional. Një tjetër kriter për trajnerët që shkojnë në garë është numri më i madh i garuesve. Një trajner mund të ftohet në garë për mundësinë për të ndihmuar atletët në disiplina të shumta atletike.

Neni 32.

Trajneri mund të ftohet në garë bazuar në njohuritë dhe aftësitë e tij shtesë, si aftësitë organizative, njohuritë e një gjuhe të huaj dhe përvojën në zhvillimin e disiplinës së caktuar.

5.2 Garat ekipore

Neni 33.

Bazuar në kriteret që përcaktojnë suksesin në vetë garën, një trajner do të ftohet për garat ekipore, në varësi të numrit dhe cilësisë së atletëve që stërvi.

5.3 Përgatitjet

Neni 34.

Trajnerët udhëtojnë drejt përgatitjeve në bazë të kritereve të përcaktuara nga rregullorja e performancës së atletëve në konsultim me Këshillin Profesional. Në këtë kuptim, zbatohen të njëjtat dispozita që zbatohen për garat.

5.4 Kryetrajneri i përgatitjeve

Neni 35.

Kryetrajneri është menaxher i përgatitjeve për procesin stërvitor. Në rast se ai nuk mund të jetë në vendin ku zhvillohen përgatitjet, ai emëron zëvendësin e tij të përgatitjeve.

Neni 36.

Kryetrajneri është i ngarkuar për kryerjen e përgatitjeve, koordinimin ndërmjet trajnerëve, bashkëpunimin me personat kompetentë të hotelit, stadiumit atletik apo sallës. Përveç kushteve të përmendura tashmë, kryetrajneri dhe drejtuesi i përgatitjes do të zgjidhen në bazë të përvojës dhe aftësive të dëshmuara organizative.

Neni 37.

Menaxheri i përgatitjeve dhe kryetrajneri i përgatitjeve kanë të gjitha kompetencat nga organizative deri tek ato ndëshkuese ndaj të gjithë anëtarëve të ekipit kombëtar - sportistëve, trajnerëve dhe stafit mjekësor.

6. Stafi mjekësor

Neni 38.

Përbërja dhe numri i personelit mjekësor përcaktohet nga Kryetari i Komisionit Shëndetësor në konsultim me Këshillin Profesional.

6.1 Doktor i ekipit kombëtar

Neni 39.

Komisionit të shëndetësisë FAK-ut, pas konsultimit paraprak me Këshillin Profesional, përcakton mjekun që do të jetë pjesë e kombëtares.

6.2 Fizioterapist

Neni 40.

Komisionit të shëndetësisë FAK-ut pas konsultimeve paraprake me Këshillin Profesional përcakton fizioterapistin e kombëtares që do të jetë pjesë e kombëtares.

7. Udhëheqësi i rrugës

7.1 Udhëheqësi i rrugës

Neni 41.

Bordi i FAK-ut emëron udhëheqësin e rrugës me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të FAK-ut.

Është e dëshirueshme që personi i caktuar si udhëheqës i garës të flasë dhe të shkruajë anglisht, si dhe të ketë përvojë në organizimin dhe zbatimin e udhëtimit dhe garave.

Udhëheqësi i rrugës ka të gjitha kompetencat nga organizative deri tek ato ndëshkuese ndaj të gjithë anëtarëve të ekipit kombëtar - sportistëve, trajnerëve dhe stafit mjekësor.

7.2 Drejtuesi i ekipit

Neni 42.

Trajneri i kombëtares është edhe drejtuesi i ekipit. Udhëheqësi i ekipit dhe drejtuesi i ekipit kanë të gjitha kompetencat, nga organizative në disiplinore, ndaj të gjithë anëtarëve të ekipit kombëtar - sportistëve, trajnerëve dhe stafit mjekësor.

8. Dispozitat përfundimtare

Neni 43.

Mosnjohja e dispozitave të kësaj Rregulloreje nuk i përjashton nga përgjegjësia pjesëmarrësit e veprimeve përfaqësuese.

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj Rregulloreje sjell përgjegjësi disiplinore.

Neni 44.

Interpretimi i kësaj Rregulloreje jepet nga Bordi i FAK-ut.

Neni 45.

Kjo rregullore hyn në fuqi shtatë ditë pas datës së publikimit në faqen zyrtare të Federatës.

Prishtinë, më
01.12.2022

Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani

